



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 5 Shkurt 2021

Nr: 39

VENDIM

PËR

**DEKLARIMIN TË PËRFUNDUAR DHE PA VENDIM PËRFUNDIMTAR TË
PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË SHQYRTIMIT TË REZULTATIT TË
VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR ISH-FUNKSIONARIN
PUBLIK Z. GERI (OLGER) SABRI ZOGU, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR
GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE
USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”.**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 8, pika 10, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; nenet 90 pikat 2 e 3, 95, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 67/2 prot., datë 26.01.2021, me lëndë “Dërgohet Vendimi për miratimin e rezultateve të verifikimit” për subjektin vetëdeklarues z. Geri (Olger) Sabri Zogu, këshilltar në Këshillin Bashkiak Gramsh,

VËREN

I.

- a) Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për subjekte si më poshtë:
- Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë;
 - Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;
 - Kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak;
 - Kandidatët për deputet dhe në organet e qeverisjes vendore.

- b) Z. Geri Sabri Zogu, si kandidat i listës shumemërore për anëtar në këshillin e bashkisë Gramsh, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit më datë 13.05.2019, referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
- i. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 3614 prot., datë 15.05.2019 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe me shkresën nr. 3619 prot., datë 15.05.2019, ka kërkuar informacion zyra e gjendjes civile.
 - ii. Me shkresën nr. V-1511/1 prot., datë 16.05.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka paraqitur vërtetimin se subjekti deklarues z. Geri Sabri Zogu figuron me statusin "I Padënuar" brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
 - iii. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka paraqitur të dhënat personale për subjektin deklarues z. Geri Sabri Zogu.
 - iv. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me Vendimin Nr. 538 datë 18.05.2019 ka vendosur të njoftojë KZAZ Nr. 51, të vijojë procedurat për regjistrimin e listës shumemërore.
- c) Më datë 04.09.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, njoftohet me shkresën nr. 5429 prot., për krijimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Gramsh, si pasojë e dorëheqjes nga mandati i anëtarit të këshillit bashkiak z. Geri Zogu, i propozuar nga subjekti politik Partia e Gjelbër.

II.

- a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të detyrave të përcaktuara në Kreu V, pika 3, shkronja "ç", të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, për shkak të deklarimit të të dhënave për dëbim nga territori i një shteti të huaj, me shkresën nr. 14093 prot., datë 31.07.2019, ka përcjellë të dhënat e administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për kontroll të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, për subjektin deklarues z. Geri Sabri Zogu, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Gramsh, Qarku Elbasan.
- b) Me shkresën nr. 67/2 prot., datë 26.01.2021, Prokurori i Përgjithshëm, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin e rezultatit të Verifikimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike", për subjektin z. Geri (Olger) Sabri Zogu, me funksion këshilltar për këshilltar në këshillin bashkiak Gramsh.

c) Sipas vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme, “Për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin z. Geri (Olger) Sabri Zogu”, rezulton se Prokuroria e Përgjithshme i është drejtuar institucioneve të ndryshme për verifikim të mëtejshëm:

- i. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. V-2578/1 prot., datë 07.08.2019 ka vënë në dispozicion të Prokurorisë së Përgjithshme dokumentin “Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore nr. 11 prot., datë 06.08.2019, sipas të cilës rezulton se z. Geri (Olger) Zogu, i biri i Sabri dhe Zymbyle, figuron “ I Padënuar” brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
- ii. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 8699/1 prot., datë 19.11.2019, ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme të dhënat personale të subjektit z. Geri Sabri Zogu, sipas Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile. Referuar këtyre të dhënave rezulton se subjekti Geri Zogu, me atësi Sabri dhe amësi Zymbyle, në datë 19.12.2007 ka ndryshuar përbërësin e gjendjes civile, rubrikën e emrit nga “Olger” në “Geri”.
- iii. Nga verifikimet e kryera nga Prokuroria e Përgjithshme në sistemin TIMS, rezulton se z. Geri (Olger) Sabri Zogu, ka të njëjtat gjeneralitete të cilat i ka deklaruar në Formularin e Vetëdeklarimit. Në sistem, në datë 09.06.2005 rezulton të jetë shpallur në kërkim nga komisariati i policisë Gramsh.
Në datë 27.06.2008 ka të regjistruar një tentativë për kalim kufiri në pikën kufitare të portit të Sarandës ku pasi është shoqëruar është lënë i lirë. Lidhur me këtë fakt, nga verifikimi manual i regjistrave të procedimeve penale në Prokurorinë Elbasan dhe ish-Prokurorinë Gramsh, nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në ngarkim të këtij shtetasi.
- iv. Në funksion të verifikimeve të thelluara janë shkëmbyer informacione me agjenci ligjzbatuese të cilat janë të klasifikuara “Sekret”.
- v. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. 2894/1 prot., datë 02.10.2019, ka vënë në dispozicion vendimin penal nr. 174, datë 27.10.1999 i cili konstatohet se i përket shtetasit Alger Zogu, i biri i Akliut dhe Aishesë, i datëlindjes 1978, lindur në Gjergjovicë, me identitet të ndryshëm nga ai i subjektit vetëdeklarues Geri (Olger) Zogu.
- vi. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, me shkresën nr. 11740 prot., datë 27.09.2019 informon se, në ngarkim të shtetasit Geri (Olger) Zogu ka regjistruar procedimet si më poshtë vijon:

- Procedim penal nr. 775, datë 05.10.2007 për veprën penale të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive, parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal. Me vendimin nr. 375, datë 08.10.2007, Gjykata ka vendosur vleftësimin e paligjshëm të arrestit në flagrancë ndaj shtetasit Olger Zogu dhe caktimin e masës së sigurimit “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”. Me vendimin e datës 31.10.2007, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka vendosur pushimin e procedimit penal në ngarkim të personit nën hetim Olger Zogu.
- Procedim penal nr. 2033/ 2018 për veprën penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 821 të datës 09.11.2018, ka vleftësuar si të ligjshëm arrestimin në flagrancë të shtetasit Geri Zogu, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal dhe ka caktuar masën detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore. Me vendimin nr. 2253, datë 13.05.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është vendosur pushimi i çështjes me person nën hetim shtetasin Geri Zogu, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, pasi fakti nuk përbën veprë penale. Gjithashtu është urdhëruar heqja e masës së sigurimit detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore, për shtetasin Geri Zogu.
- vii. Nga informacioni i përcjellë nga prokuroritë e tjera pranë gjykatave të apelit dhe Prokuroria e Posaçme kundër Krimit të Organizuar, rezulton se ndaj subjektit Geri (Olger) Zogu nuk janë regjistruar procedime penale, nuk ka qenë ose është nën hetim, nuk është caktuar ndonjë masë sigurimi dhe nuk është dënuar me vendim jopërfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë veprë penale.
- viii. Nga verifikimet e thelluara për shtetasin Geri (Olger) Zogu nuk figuron person i shpallur në kërkim ndërkombëtar dhe as të ketë patur të regjistruara praktika me partnerët ndërkombëtarë për përfshirjen në veprimtari kriminale. Në vitin 2014 rezulton të ketë patur një urdhër dëbimi nga Norvegjia për shkelje të ligjit të emigracionit pasi nuk ka patur leje qëndrimi.
- ix. Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. 2108/3 prot., datë 13.01.2021, ka vënë në dispozicion përgjigjen zyrtare të autoriteteve norvegjeze të drejtësisë, nga ku ka rezultuar se nuk ka asnjë person të regjistruar me këtë identitet. Shtetasi Geri Zogu ishte dëbuar për një periudhë dy vjeçare nga Norvegjia për shkak të shkeljes së Ligjit të Emigracionit. Afati i dëbimit ka skaduar në vitin 2016 dhe nuk është më në fuqi. Subjekti Geri (Olger) Zogu nuk ka asnjë masë ndëshkimore në Norvegji.

III.

- a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme vlerëson se subjekti vetëdeklarues z. Geri Sabri Zogu,
- i. Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjeneralitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjeneralitetet e tij dhe është shprehur se ka ndryshuar emrin nga “Olger” në “Geri”.
 - ii. Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 4 “A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po”. Organ procedues është deklaruar komisarati i policisë Elbasan, për kryerjen e veprës “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, më datë 06.11.2018;
 - iii. Po këtu, pyetjes 7 “A është marrë ndonjëherë për ku masa e dëbimit nga një shtet i huaj (me përjashtim të rastit kur jeni dëbuar ekskluzivisht për shkeljen e rregullave të emigracionit që kanë të bëjnë me rregullat e qëndrimit apo të hyrje daljes në një territor të një shteti të huaj”, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se është dëbuar nga Norvegjia si person i padëshirueshëm, për një periudhë 4 vjeçare;
 - iv. Po këtu, pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se një muaj”, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se ka qendruar në Greqi, Norvegji, Itali dhe Belgjikë për arsye ekonomike.

Pas rezultatit të verifikimit për subjektin z. Geri (Olger) Sabri Zogu, me detyrë ish këshilltar në këshillin e bashkisë Gramsh, nuk rezulton të ketë indicie për vepra të tjera të kryera brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të parashikuara si ndalime në nenin 2, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Subjekti z. Geri Sabri Zogu, ka dhënë dorëheqjen, nga funksioni i tij si këshilltar në këshillin e Bashkisë Gramsh dhe për rrjedhojë nuk është subjekt i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, por në zbatim të nenit 8, pika 10 të këtij ligji, thuhet se, nëse verifikimi ka nisur përpara përfundimit të mandatit, procedura e verifikimit kryhet deri në arritjen e konkluzioneve përkatëse.

Për sa më sipër, subjekti vetëdeklarues z. Geri Sabri Zogu, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 8, pika 10, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, nenet 90 pikat 2 e 3, 95, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”,

VENDOSA:

1. Të deklaroj të përfunduar procedurën administrative pa vendim përfundimtar, për shkak të dorëheqjes së z.Geri (Olger) Sabri Zogu, nga funksioni i anëtarit të këshillit bashkiak Gramsh.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

